

VENDIM
Nr. 6, datë 9.2.2015

**PËR ADMINISTRIMIN “TRANZITOR” TË PROJEKTEVE ME AUTORITET
KONTRAKTUES KOMUNAT, NË PERIUDHËN SHKURT- SHTATOR 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, tee ligjit nr.160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, në zbatim të ligjit nr.115/2014, “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Komunat, si autoritete kontraktuese për kontratat e nënshkruara për zbatim punimesh, duhet të sigurojnë përfundimin e zbatimit të projekteve të financuara në vazhdim, me cikël financimi-zbatimi deri në vitin 2014, përpara datës 30.6.2015. Përfundimi i punimeve përfshin dorëzimin e objektit dhe dokumentacionin përkatës tekniko - financiar për zbatimin e projektit dhe proceset e kolaudit, kur grafiku i afateve të zbatimit të projektit e mundëson/lejon këtë, si edhe kryerjen e pagesave financiare.

2. Për komunat, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të cilat nuk arrijnë të respektojnë afatin e vendosur, do të pezullohet financimi dhe zbatimi i tyre. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet, të cilat burojnë nga zbatimi i kontratave të nënshkruara nga komunat për projektet me burim financimi Fondin për Zhvillimin e Rajoneve, i transferohen njësisë së re të qeverisjes vendore në të cilën komuna “përthithet” sipas ndarjes së re administrative dhe territoriale, sipas ligjit nr.115/2014, datë 31.7.2015. Komunat me projekte dhe kontrata punimesh të papërfunduara, duhet të vënë në dispozicion /transferojnë tek njësia e re territoriale që i përthith, dokumentacionin administrativ, për të gjitha fazat e ndjekura dhe të planifikuara, deri në zbatimin e plotë të kontratës.

3. Vijimi i zbatimit të projektit mund të kryhet nëpërmjet delegimit të funksioneve (kontratave) përmes marrëveshjeve të delegimit me njësi të qeverisjes vendore bashkinë qendër, e cila do të “përthihet” si njësi, në ndarjen e re territoriale, komunën autoritet kontraktues, sipas ligjit nr.115/2014, datë 31.7.2014, “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

4. Financimi i projekteve të reja (përveç programit të Shqipërisë Dixhitale), gjatë vitit 2015, me vendndodhje territorin e komunave, do të kryhet për ato projekte ku aplikuesi komunë ka arritur një marrëveshje delegimi, dhe/ose partneriteti rajonal, me një prej institucioneve të mëposhtme:

a) Fondin Shqiptar të Zhvillimit;

b) këshillin e qarkut përkatës.

ku këto të fundit, si aplikant dhe autoritet kontraktues, do të zbatojnë projektin në emër dhe për llogari të komunës në territorin e të cilës shtrihet projekti.

5. Ngarkohen sekretariatet teknike, ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar.